


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Shtator 2018

**Tiranë, më 17 Tetor 2018:** Në Shtator 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 26 mld lekë, duke u rritur me 8,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 28,0 %, në krahasim me Gusht 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 51 mld lekë, duke u ulur me 4,7 %, në krahasim me një vit më parë dhe rritur me 5,5 %, në krahasim me Gusht 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 25 mld lekë, duke u ulur me 15,6 %, krahasuar me Shtator 2017 dhe me 11,1 %, në krahasim me Gusht 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në nëntëmujorin e vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 231 mld lekë, duke u rritur me 15,3 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 467 mld lekë, duke u rritur me 3,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 235 mld lekë, duke u ulur me 6,7 %, krahasuar me 2017.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 8,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,9 pikë përqindje“. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,8 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2018**




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë rritur me 15,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,04 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rënia vjetore e importeve prej 4,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,0 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,7 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2018**



Si nëntëmujor, importet janë rritur me 3,0 %, krahasuar me nëntëmujorin 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Shtator 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2017 janë: Italia (0,9 %), Kosova (50,0 %) dhe Spanja (47,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (-77,8 %), Turqi (-1,9 %) dhe Ukraina (-54,0 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (3,9 %), Kosova (25,0 %) dhe Spanja (63,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kina (-38,3 %), Turqia (-5,6 %) dhe Ukraina (-53,1 %).

Në muajin Shtator 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2017 janë: Greqia (13,8 %), Turqia (15,4 %) dhe Kina (8,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-7,3 %), Gjermania (-23,3 %) dhe Rusia (-2,2 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Greqia (2,8 %), Turqia (5,1 %) dhe Kina (8,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania (-4,5 %), Zvicra (-23,6 %) dhe Ukrainë (-17,1 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,4 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,8 %), Greqia (7,6%), Turqia (6,2 %) dhe Kina (5,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin 2018, me vendet e BE zënë 66,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,6 %), Greqia (7,0 %), Gjermania (6,7 %) dhe Kina (6,0 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-28	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-30	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-28	42,8
	Janar - Shtator 16	177	-4,6	424	8,2	-247	41,8
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	Janar - Shtator 17	201	13,4	453	6,8	-252	44,3
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,7	-27	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 17	26	8,7	51	-4,7	-25	51,4
	Janar - Shtator 18	231	15,3	467	3,0	-235	49,6

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte							
	Sht-17	Shtator 2018	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018	Shtator 2017	Shtator 2018	Jan- Sht 2017	Jan- Sht 2018
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>18.724</b>	<b>20.038</b>	<b>154.093</b>	<b>176.734</b>	<b>31.478</b>	<b>31.108</b>	<b>280.332</b>	<b>287.657</b>
Austri	117	151	1.184	1.300	612	578	4.693	5.026
Mbretëri e Bashkuar	10	85	321	697	382	479	3.820	4.316
Gjermani	904	974	8.146	10.173	4.529	3.474	37.973	36.269
Greqi	978	1.122	8.676	9.809	4.182	4.760	37.980	39.051
Itali	13.050	13.168	107.489	111.709	14.682	13.608	129.724	129.723
Spanjë	1.452	2.141	10.950	17.861	898	2.059	10.167	10.933
Kroaci	79	65	603	645	209	480	3.182	4.996
Të tjera të BE-së	2.133	2.331	16.724	24.540	5.983	5.669	52.793	57.342
Kinë	1.094	243	6.704	4.140	3.959	4.283	35.002	38.005
Kosovë	1.738	2.608	15.575	19.464	830	849	6.155	6.441
Maqedonia	745	756	6.420	6.482	906	935	6.305	7.023
Rusi	3	2	79	31	1.057	1.034	8.353	10.399
SHBA	124	738	2.090	3.924	675	898	6.676	6.695
Turqi	181	177	1.649	1.556	3.972	4.582	36.642	38.503
Ukrainë	44	20	381	178	141	173	2.391	1.981
Zvicër	128	51	961	2.807	2.512	626	8.637	6.603
Të tjera	1.295	1.529	12.820	16.123	7.852	6.394	62.671	63.523
<b>Gjithsej</b>	<b>24.076</b>	<b>26.160</b>	<b>200.773</b>	<b>231.439</b>	<b>53.383</b>	<b>50.881</b>	<b>453.164</b>	<b>466.829</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2017	Shtator 2018	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018	Shtator 2017	Shtator 2018	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018
<b>Gjithsej</b>	<b>24.076</b>	<b>26.160</b>	<b>200.773</b>	<b>231.439</b>	<b>53.383</b>	<b>50.881</b>	<b>453.164</b>	<b>466.829</b>
Ushqime, pije, duhan	2.197	2.552	20.394	22.327	8.675	8.819	79.297	80.266
Minerale, lëndë diegëse, en,el.	3.528	4.092	32.841	44.065	7.430	5.249	44.621	47.256
Produkte kimike dhe plastike	442	901	3.582	4.583	6.977	6.751	64.446	65.009
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	266	229	2.227	2.145	1.363	1.475	13.792	13.962
Prodhime druri dhe letre	822	851	5.788	6.464	2.284	1.968	17.457	18.401
Tekstile dhe këpucë	10.671	10.859	87.663	92.997	7.327	7.498	62.445	63.898
Materiale ndërtimi dhe metale	3.867	4.627	31.913	40.165	6.200	6.549	57.485	57.623
Makineri, pajisje dhe pj, këmb.	1.631	1.438	10.825	12.593	11.393	10.836	96.105	102.191
Të tjera	654	611	5.541	6.100	1.734	1.737	17.517	18.223

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>107.489</b>	<b>111.709</b>	<b>10.950</b>	<b>17.861</b>	<b>15.575</b>	<b>19.464</b>	<b>8.146</b>	<b>10.173</b>
Ushqim, pije duhan	5.308	5.533	585	917	2.097	2.038	1.062	1.055
Minerale, lëndë djegëse, ener, elek,	5.826	3.765	8.245	14.233	3.953	4.396	847	1.684
Produkte kimike dhe plastike	993	1.161	13	44	938	968	19	23
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.678	1.577	57	189	4	6	13	6
Prodhime druri dhe letre	4.090	4.488	5	286	302	342	83	121
Tekstile dhe këpucë	68.639	71.614	1.812	2.029	94	85	4.233	5.300
Materiale ndërtimi dhe metale	11.911	13.296	225	124	6.783	10.026	838	572
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.537	7.438	1	30	516	641	833	1.000
Të tjera	2.508	2.837	7	10	888	963	217	412

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Greqi		Turqi		Kinë	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>129.724</b>	<b>129.723</b>	<b>37.980</b>	<b>39.051</b>	<b>36.642</b>	<b>38.503</b>	<b>35.002</b>	<b>38.005</b>
Ushqim, pije duhan	13.565	13.199	10.513	11.594	4.246	4.248	456	518
Minerale, lëndë djegëse, ener, elek,	11.719	9.717	5.988	6.416	1.311	583	7	6
Produkte kimike dhe plastike	13.746	13.683	6.063	5.765	5.360	6.033	3.667	3.581
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	10.646	10.689	56	47	268	234	559	570
Prodhime druri dhe letre	4.737	5.447	2.403	2.530	2.479	2.447	807	831
Tekstile dhe këpucë	31.298	31.409	2.912	2.752	11.260	11.910	7.838	7.455
Materiale ndërtimi dhe metale	14.508	15.404	6.915	6.442	4.307	5.668	4.525	5.185
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	24.985	25.795	1.825	2.143	5.746	5.591	13.460	16.187
Të tjera	4.518	4.379	1.307	1.362	1.665	1.788	3.683	3.670

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore,

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci,

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri